

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dënimet në Hagë: Midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/20/denimet-ne-hage-midis-solidaritetit-njerezor-ndaj-te-a-kuzuarve-dhe-keqkuptimeve-alla-shqiptare-per-drejtesine/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 15:59:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	20 shtator 2026, 15:57:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 20 shtator 2026, 15:56:00 UTC → 20 shtator 2026, 15:58:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t'ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	c90a99a4cf98e9c6d7e808b1fd44fbac7caf4033332e5c1f5d38deb68882b921
TEKSTI	2c752dfa9c2be918a891785e1aff9f63afb7c566ce0ce1369be6f1a1cb25905d
PAMJA	8e5b46d6df90c7b40b5c76910b0cb60229c5f6b37390fbc94ec6279feccd8190

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	00f206f43e8faf3a345288842cb433c4a592e4171301c0f726965a279636da13
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	27cd3d5362ad8606db4b4a4bb83953e8ab924c30f9fa24532364779df926f41e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/00f206f43e8faf3a345288842cb433c4a592e4171301c0f726965a279636da13>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

OPINION | TË FUNDIT

Dënimet në Hagë: Midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë

20/09/2026 17:57



*Preç Zogaj

Po i quaj të akuzuar ish-drejtesit e UÇK-së: Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimi, sa kohë që nuk janë dënuar me vendim të formës së prerë. Ata kanë një mundësi të dytë në Gjykatën e Apelit.

Dënimi i tyre në shkallën e parë ishte paralajmëruar me shenja të shumta përgjatë procesit maratonë të hetimit. Sikurse edhe me thirrjet për qetësi nga Brukseli dhe Uashingtoni në prag të verdiktit të parë, duke na kujtuar se ai nuk është përfundimtari.

Befasia në këtë fazë të gjykimit ishte masa e dënimeve. Shumë të rënda për aq prova konkrete sa ka paraqitur akuza. Shproporcionale në raport me disa dënime (jo të gjitha) që Gjykata Ndërkombëtare e Hagës ka dhënë për kriminelë serbë, të dënuar për krime kundër njerëzimit në dëm të qytetarëve kosovarë me kombësi shqiptare.


Zemërimi i mbështetësve të Thaçit me shokë është legjitim. Solidariteti ndaj tyre i qindra mijëra shqiptarëve në Kosovë, Shqipëri dhe diasporë është i natyreshëm. Të gjithë presin me padurim dhe shpresë fjalën e Gjykatës së Apelit – e vetmja shkallë gjykimi e mbetur që mund t'i japë një kthesë procesit, duke dhënë në rastin më të mirë pafajësi për të akuzuarit, ose dënime më të buta në masën e viteve të paraburgimit, gjë që do të nënkuptonte lirin e tyre.

Te Apeli bëhet beteja tani. E fundit. Betejë ligjore. Mundësi tjetër jashtë kornizës ligjore nuk ka në hapësirën e botës demokratike, nga Uashingtoni në Bruksel, ku sundon prej shekujsh e dekadash ndarja demokratike e pushteteve – legjislativi, ekzekutivi, drejtësia – dhe pavarësia e tyre. Ky është themeli i botës së lirë.

Nuk është fasadë, siç mendojnë të keqkuptuarit e demokracisë liberale, duke bërë lidhje pa lidhje me regjimet autokratike, ku krerët e qeverive apo shteteve janë de facto kryeprokurorë e kryegjyqtarë.

Këtë keqkuptim e shohim të shpërfaqet bujshëm këto ditë në Shqipëri, në "garën" se kush e kush të këpusë thagmën më të madhe kundër Gjykatës së Hagës, sikur ajo të ishte kapur politikisht nga Rusia, Serbia, apo nga qendra të tjera antishqiptare në SHBA dhe Europë! Po ashtu edhe në "garën" tjetër se çfarë duhet bërë e nuk është bërë deri

Kryesore



Foto/ Viktima që u ekzekutua njëhëj me emrin "Tani Ruzhdiut", plagosja e dy personave me armë zjarri në Sarandë solli sagën e hakmarrjes

10:53

Angli/ Katër 17-vjeçarë shqiptarë të "zhdukur", kërkohet ndihma publikut për t'i gjetur (Fotot)

12:06

"Qeveria synon të zhvillojë projekte pilot me komunitetet që merren me turizëm", Rama në podkastin "Flasim": Pasuria natyrore është një pjesë thelbësore

11:26

Zgjedhjet rajonale në Gjermani vënë nën presion Friedrich Merz, rezultatet e dobëta të CDU-së mund të hapin debat për të ardhmen e kancelarit

11:19

PSG, Al Khelaifi në telashe, hetohet në Francë për konflikt interesi

14:06

Më të lexuarat

Sapo ishte ulur për kafe në një lokal, 44-vjeçari tentoi t'i largojë me vrap autorëve, por u vra në mes të rrugës

Angli/ Katër 17-vjeçarë shqiptarë të "zhdukur", kërkohet ndihma publikut për t'i gjetur (Fotot)

U vra me armë zjarri në rrugë, ja kush është viktima në Sarandë, rezultoni i arrestuar në 2025

Foto/ Viktima që u ekzekutua njëhëj me emrin "Tani Ruzhdiut", plagosja e dy personave me armë zjarri në Sarandë solli sagën e hakmarrjes

"Për Enverin yll e dritë... Qajnë pleqtë qajnë të rinjtë"/ Korreshi ndan videon nga Lushnja: U glorifikua diktatori brenda muzeut

Detajet/ Vrasje me armë zjarri në Sarandë, plagoset dhe një kalimtar. Viktimës iu zu pritë nga autorët

Meloni paralajmëron masa të reja në shkollat në Itali: Kufizim për nxënësit e huaj dhe ndalim të burkave e hixhabeve

VIDEO/ "Për Enverin yll e dritë...", Biblioteka e Lushnjës përgënjeshtro lajmin e Saimir Korreshit: Ja si qëndron e vërteta

Përshkallëzohet konflikti mes Jemenit dhe

tani për të shpetuar kater ish-luftetaret. Fjale, fjale, fjale. Hipokrizi dhe lot krokodili për t'u dukur si patriotë të mëdhenj.

Gjithë "propozimet" për të treguar forcë, pa e pasur të qartë ku dhe si, kthehen si dallga që përplasen me shkëmbin; sillen nga sillen dhe reduktohen në një: sensibilizim dhe lobim i fuqishëm. Ku? Pranë vendeve aleate dhe mike, duke pasur parasysh SHBA-në dhe vendet e fuqishme të BE-së. Me çfarë? Me lutje për ndërhyrje pranë gjykatës, apo me diversionin se mund të bëhet nami. Ka prej atyre që me lobim kuptojnë blerjen e vendimit në shkallën e dytë, meqenëse po fiton bindja se një gjë që nuk blihet me para, mund të blihet me shumë para! (Për ata që mendojnë se Gjykata është kapur nga Rusia dhe Serbia, i bie se duhet blerë Putini dhe Vuçiçi)!

Injoranca apo qëllimi i mbraptë në këtë rast po shpalos një vetëdemaskim në shkallë të gjerë të raportit antidemokratik me drejtësinë, duke e menduar atë si vegël dhe notere të politikës. Ky është një qëndrim që vjen si zgjatim i raportit të vjetër të politikanëve tanë me drejtësinë brenda Shqipërisë, i armiqësisë së tyre me SPAK-un dhe GJKKO-në.

Duhet kujtuar se kjo përpjekje e ndërhyrjes në favor të Thaçit dhe tre të tjerëve është konsumuar nga kryeministri Rama në instancën më të lartë politike të botës, që është Presidenti Trump. Në mbledhjen e parë të Bordit të Paqes në shkurt të këtij viti, Rama i harxhoi një pjesë të minutave të ndërhyrjes së tij për të ngritur çështjen e të katërve. Ai përdori si ystës emrin e "djallit" Jack Smith – prokurorit që ka akuzuar Thaçin – me qëllim që t'i ndizte Presidentit amerikan llambën e tërbimit, duke qenë se Smith "gëzon" botërisht armiqësinë ekstreme të tij, pasi e pat paditur penalisht me akuzën se ishte përpjekur të përmbyste rezultatin e zgjedhjeve presidenciale të vitit 2020.

Një ndërhyrje e guximshme kjo e kryeministrit tonë, jashtë rendit të ditës, që prodhoi lajm në Shqipëri dhe Kosovë. Asgjë tjetër pozitive, në mos u bëri dëm Thaçit me shokë. Dhe s'mund të prodhonte tjetër gjë. Nga mënyra si e shtroi dhe ku e shtroi çështjen, Rama tradhtoi vizionin e tij të shtrembër për drejtësinë, duke paragjykuar edhe Presidentin si të tillë. Nuk them se nuk e kishte për zemër punën e Thaçit, por politikanët e tregojnë zotësinë e tyre në rrugën e duhur që gjejnë për të ndihmuar.

Në fakt, heronjtë e spektakleve dhe zhurmave pa lidhje me organizimin specifik të drejtësisë si pushtet i pavarur nuk ndihmojnë, madje bëjnë keq. SHBA-ja dhe BE-ja nuk kanë çfarë të mësojnë nga Tirana për këtë temë. Ata janë kokë e këmbë në historinë e Kosovës. Të kërlesh t'u japësh mend atyre është si në shprehjen popullore: "Hajde baba të të tregoj arat".

Ata e kanë çliruar dhe pavarësuar Kosovën. Ata janë emri i parë i lirisë së saj. UÇK-ja vjen e dyta me vulën e nderit dhe me gjakun e derdhur për liri. LDK-ja dhe Rugova vijnë ndërkaq me rezistencën paqësore dhjetëvjeçare që ndërkombëtarizoi çështjen e Kosovës, ndërtoi dhe nguliti kornizën e aspiratave të saj perëndimore, si dhe përligjii daljen në skenë dhe pranimin ndërkombëtar të UÇK-së si faktor politik dhe ushtarak. Këto realitete nuk ka forcë që t'i zhbëjë.

SHBA-ja dhe BE-ja janë gjithashtu krijuesit dhe lobuesit e miratimit nga Parlamenti i Kosovës të Gjykatës Speciale me seli në Hagë, me prokurorë dhe gjyqtarë ndërkombëtarë. Ky vendim sui generis ka pasur një kontekst sui generis: Drejtësia e re e Kosovës së pavarur, ku ish-komandantët e UÇK-së u bënë drejtues të institucioneve shtetërore, dështoi të hetonte qindra vrasje, zhdukje dhe pengmarrje civilësh e deputetësh shqiptarë, të kryera kryesisht në kohën kur po merrnin udhë bombardimet e Serbisë nga NATO dhe pas çlirimit të Kosovës.

Disa prej emrave të këtyre fatkeqësive i dëgjuam në pretencën e akuzës dhe në vendimin e gjykatës.

Kosova nuk mund të gjejë paqe pa bërë drejtësi për këto viktime, për këto krime, kushdo që t'i ketë kryer. Verdikti i drejtësisë, me fajtorë të vërtetë dhe jo me koka turku, është vet kjo paqe.

*Ky shkrim është pjesë e projektit 'PRODEMOCRATIA, një partneritet mes INSTITUTIT PASHKO dhe media MAPO, për të analizuar zhvillimet e demokracisë shqiptare.

*Drejtori i MAPO

Top Channel

Arabisë Saudite, breshëri dronësh nga Huthit: Përgjigje ndaj 300 sulmeve ajrore

Vrau gruan se ndihmonte vajzën/ Detaje nga krimi brenda familjes në Tiranë, Hysni Patushi qëlloi bashkëshorten se kujdesej për 4 nipërit

I Opinion »



Kosova në Hagë, Shqipëria në 'Ballkanin e Hapur' dhe me 'Shtetin Bektashi'!

20/09 13:52



Ushtritë e tastierës përkundrejt interesit Kombëtar

19/09 15:34



"Shteti që mëson"

19/09 12:09



Top Poll: Zhgënjim i madh i shqiptarëve nga Gjykata e Hagës

18/09 16:51



"Nga kodi i etikës te algoritmi"

18/09 12:51



Pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve: Kush e paguan moszbatimin e Kushtetutës?

17/09 16:08

Na ndiqni:



I Video »



Top News – Trump do t'i ndryshojë emrin IA / 'Duhet ta quajmë Inteligjencë Supreme ose Ekstreme'



Top Channel/ 'Toyota Auris' përfshihet nga flakët pranë kthesës së Picarit, shkrumbohet e gjitha



Top News – Trump kthehet urgjentisht në zyrë / SHBA lëshon alarmin: Përshkallëzim në Arabinë Saudite



Top News – Haga nis kompensimin e viktimave...Pa pritur vendimin e apelit, reagime në Kosovë



Top Channel/ Zjarr në Babicë të Vlorës, flakët rrezikojnë një banesë. Ndërhyjnë forcat zjarrfikëse



Top News – Studentët kundër vendimit të Speciales/Protestë e madhe në Prishtinë, thirrje për unitet

Lajme

Lajmet e fundit
Politikë
Kronikë
Aktualitet
Ekonomi
Sociale
Video
Top News LIVE

Bota

Opinion
Koment
Kosova dhe Rajoni
Shkencë dhe Teknologji
Auto

Sport

Kombëtarja
Kategoria Superiore
Kategoria e Parë
Premier League
La Liga
Serie A
Shumësportësh
Sport Gossip

Pop News

Showbiz
Lifestyle
Fashion
Shëndeti
Dieta
Receta gatimi

Programe

Big Brother VIP
Për'puthen
Shqipëria LIVE
Fiks Fare
Video
Të gjitha programet
Guida TV

Top Channel

Rreth Top Channel
Topin e kam unë – Apliko tanil
Kontakt
Puno në Top Channel
Privacy Policy & Terms of Use
Aksesueshmëria

© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.